



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**  
**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 25 . 06 .2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Drejtuar **“Inpress” sh.p.k., me NIPT L52122014L**

Adresa: Rruga Ish Blloku i Magazinave te Tregtise, Rruga Siri Kodra TIRANE

Procedura e prokurimit/lotit: *“Procedurë e hapur e thjeshtuar- mallra –“Marrëveshje kuadër”*

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-91142-12-15-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *“Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”*, me fond limit 1,484,255 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike- Nuk ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik **“F.L.E.SH.” sh.p.k., me NIPT J91801004M,**

Vlera e ofertës pa tvsh = 940,725 [nëntëqind e dyzetë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë] lekë

2. Operatori ekonomik **“FILARA” sh.p.k., me NIPT K51611059N,**

Vlera e ofertës pa tvsh = 1,325,377 [një milion e treqind e njëzetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë] lekë

3. Operatori ekonomik **“Inpress” sh.p.k., me NIPT L52122014L**

Vlera e ofertës pa tvsh = 1,061,974 [një milion e gjashtëdhjetë e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër] lekë

4. Operatori ekonomik **“KRISTALINA.KH” sh.p.k., me NIPT K11501002D**

Vlera e ofertës pa tvsh = 1,410,720 [një milion e katërqind e dhjetë mijë e shtatëqind e njëzetë] lekë.

5. Operatori ekonomik **“ONUFRI” sh.p.k., me NIPT J91801003E,**

Vlera e ofertës pa tvsh = 836,200 [tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind] lekë

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **“ONUFRI” sh.p.k., me NIPT J91801003E,** me ofertë ekonomike 836,200 [tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind] lekë pa TVSH.

Për arsye se ofertat e operatorit ekonomik **“ONUFRI” sh.p.k** dhe **“F.L.E.SH”** dolën anomalisht të ulëta, ju kërkuan sqarime. Pas paraqitjes së sqarimeve u mbajt procesverbali nr. 3625/15 prot., datë 15.01.2024, ku pasi u pritën afatet e përcaktuara sipas nenin 93 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, rezulton se Operatori ekonomik **“ONUFRI” sh.p.k,** nuk ka kthyer përgjigje në lidhje me argumentimin e ofertës animalisht të ulët dhe për këtë arsye nuk kualifikohet.

2. **“F.L.E.SH.” sh.p.k., me NIPT J91801004M,** me ofertë ekonomike 940,725 [nëntëqind e dyzetë e një mijë e shtatëqind e njëzet e pesë] lekë pa TVSH.

Komisioni i Prokurimit Publik, me Vendimin nr 154/13 prot., datë 26.04.2024 e shtjelluar si më poshtë vijon duke arsyetuar pretendimin e pranuar nga ankesa e paraqitur nga Operatori Ekonomik **“Inpress” sh.p.k., me NIPT L52122014L:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe informacionit që përmban ky dokumentacion rezulton, se nga ana e operatorit ekonomik **“FLESH” SHPK** është paraqitur tabela me emërtimin **“kosto analitike për prodhimin e diplomave”,** e cila përmban analizën e koston për letër për prodhimin e diplomave vertikal me përmasa të letrës (axb) 22.4 x 33.3 cm 300gr/m<sup>2</sup>, letër për prodhimin e diplomave horizontal me përmasa të letrës (axb) 22.4x33.3 cm 300 gr/m<sup>2</sup> super fine, klishe për formatin vertikal shtyp i nxehtë dhe kuposje, klishe për formatin horizontal shtyp i nxehtë dhe kuposje, lastra për dy variantet, bojë shtypi për prodhimin e diplomave si dhe numratorin me ngjyrë të kuqe, bojë e padukshme me sy të lirë për logon UMT, varak gold shtyp të nxehtë me bobina 70 cm lineare, varak silver, për shtyp të nxehtë me bobina 70 cm lineare, varak i kuq për shtyp të nxehtë me bobina 70cm lineare, varak zi për shtyp të nxehtë me bobina 70 cm linere, hologram, bojë printeri, orë pune (shtyp, offsett, shtyp i lartë numrator, shtyp i nxehtë varak, hologram, kuposje, prerje, paketim), orë pune printim digital, transport dhe lëvizje për shërbim të prodhimit të diplomave, shpenzime të domosdoshme për konsum të ulët, detyrime tatimore, paga për kohën përkatëse të prodhimit të diplomave, energji elektrike dhe ujë bazuar në konsumin mesatar të tre muajve. mban datën 05.01.2024, ndërkohë procedura e prokurimit dhe dorëzimi i ofertës ekonomike është kryer në datë 28.12.2023.

Në këto kushte Komisioni gjykon, se referuar preventivit të zërave të ofruar, sipas parashikimeve në dokumentet e tenderit për zërat e sipërcituar nuk është paraqitur analizë kosto e detajuar duke justifikuar listën e çmimeve të ofruara në ofertën ekonomike, pasi dokumentacioni provues referuar materialeve të sipërpërmendura mban datën 05.01.2024 pas zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, operatori ekonomik “FLESH” SHPK, nëpërmjet dokumentacionit provues sa më sipër, nuk ka arritur të argumentojë elementet e ofertës së tij për të cilët autoriteti kontraktor ka kërkuar shpjegime, siç parashikohet në nenin 93 të LPP-së si më sipër cituar, duke mos krijuar bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Për arsyen e sipërcituar Operatori Ekonomik “F.L.E.SH.” sh.p.k., me NIPT J91801004M nuk kualifikohet.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**Inpress**” sh.p.k., me NIPT **L52122014L**, me adresë: “Rruga Ish Blloku i Magazinave të Tregtise, Rruga Siri Kodra TIRANE” se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1,061,974 [një milion e gjashtëdhjetë e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër] lekë pa TVSH është identifikuar si fitues përfundimtar i procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Universitetit të Mjekësisë, Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (Vendimi përfundimtar i KPP-së nr. 430/2024 Prot. datë 26.04.2024 protokolluar me tonën me nr. 3625/32 datë 26.04.2024)

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës: Nuk ka njoftim anulimi.

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Arlind BROCI**